

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË /DIVIZ.KUNDËRVAJTJËS/, me Gjyqtarin Nehat Qelaj dhe sek.juridike Nexhmije Dakaj në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Fatos Fetah Kryeziu nga fshati Bubavec, K.Malishevës, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5, 6 paragrafi 1.3 dhe 9 i ligji nr. 04/I-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, si dhe në bazë të nenit 73, 195 dhe 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet (LMK) me dt.16.12.2013 mori këtë:

A K T V E N D I M

I pandehuri: Fatos Kryeziu nga i ati Fetah i lindur me datën 10.07.1976 në fshatin Bubavec, K.Malishevës, ku edhe tani jeton, i martuar i ati i pesë (5) fëmijëve, këshilltar në KK Malishevës, gjendjës së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R.Kosovës,

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S :

Sepse në afatin prej 01 deri 31 Mars 2012 si zyrtar i lartë publik nuk e deklaroi pasurinë e tij me ç'rast nuk e përmbush obligimin ligjor që parahihet me ligjin nr. 04/I-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë dhe në këtë mënyrë nuk i përmbahet nenit 9 të të njëjtit ligj.

-me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni nga neni 5, 6 paragrafi 1.3 dhe 9 i ligji nr. 04/I-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë prandaj në bazë të këtyre dispozitave dhe në kuptim të nenit 17 paragrafi 1.3 të të njëjtit ligj si dhe konform nenit 9 të Ligjit mbi Kundërvajtjet i njëjti :

D Ë N O H E T

Me gjobë në shumën prej shtatëqind euro (700 €)

Obligohet i pandehuri që gjobën e shqiptuar të paguan në afat prej 15 dite, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi në xhirollogari të Këshillit Gjyqësor No.1000 4300 7000 0518, në të kundërtën e njëjta do të zëvendësohet me burgim në kohëzgjatje prej tridhjetegjashtë (36) ditësh duke llogaritur **15 euro** për një ditë burg, po ashtu i pandehuri obligohet që në afat të lartcekur të paguaj **10 €** në emër të paushallit gjyqësor, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Me nga një ekzemplar të këtij aktvendimi të njoftohet parashtruesi i kërkesës dhe i pandehuri.

A R S Y E T I M

Agjensioni Kundër Korrupsionit parashtroi kërkesën nr.01-2147/2012 të datës 15.06.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit Fatos Fetah Kryeziu nga fshati Bubavec, K.Malishevës, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5, 6 paragrafi 1.3 dhe 9 i ligji nr. 04/I-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Gjyqtari i qështjës caktoi senac për shqyrtimin e kësaj çështje dhe ftoi të pandehurin që me datën 08.04.2013 të paraqitet në gjykatë që të deklarohet në mbrojtjen e tij për kundërvajtjen me të cilën ngarkohet.

 REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO AGENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY		
Dep. Dep. DPK / DMP Nr. llog. Llog. shifra Nr. pages	02	Nr. Prot. Nr. Prot. 03-4546/13 Data Datum 31.12.2013
PËRSHITJE		

03-4546/13/02
Kuj

I pandehuri është paraqitë në gjykatë sipas ftesës së kësaj gjykate dhe në seancës e datës 08.04.2013 pasi që i'u komunikua kërkesa për hapjen e procedurës kundërvajtëse ndaj tij dhe kundërvajtjen me të cilën ai ngarkohet i njëjti për këtë çështje deklaroi se: është e vërtetë se nuk e ka deklaruar pasurin për vitin 2012 te Agjensioni AntiKorrupsion dhe është e vërtetë se as me shkrim e as gojarisht nuk kam qen i njoftuar nga zyrtari përkatës i komunës për këtë çështje andaj e them me plot përgjegësi se nuk kam qen ne dijeni se duhet ta bej ket.

Lidhur me këtë çështje me datë 28.10.2013 si dëshmitar është ndëgjuar Muharrem Morina pikë kontaktuesë në mes të KK Malishevës dhe Agjensioni Kundër Korrupsionit I cili lidhur me këtë çështje deklaroi se sa i përket deklarimit te pasuris të antarit te KK Malishevës konkretisht per antarin e Kuvendit Fatos Kryziu dhe të gjithë antarët tjerë në seancen e kuvendit në muajin shkurt i kam njoftuar se të njëjtit duhet të bëjnë deklarimin e pasuris sipas ligjit nr. 04/L-50. Thekson se me shkrim nuk i ka njoftuar por siq ceku me lart të njëjtin gojarisht si gjithë të tjerët i ka njoftuar në seancën e kuvendit dhe mesa di shumica e antarëve pasi që i ka njoftuar gjatë seancës së kuvendit në afatin ligjor e kan berë deklarimin e pasuris.

Gjyqtari i çështjes pas dëgjoi të pandehurin dhe pas shiqimit të lëndës në tërsi e pa të arsyeshme të ndëgjoj Muharrem Morina pikë kontaktuesë në mes të KK Malishevës dhe Agjensioni Kundër Korrupsionit pasi që në shkresat e lëndës vërehet se i njëti ka vepruar sipas kërkesës së Agjencionit të cekur më lart duke e njoftuar me shkrim agjencionin për listen e zyrtarëve të lart publik që kërkohet sipas ligjit 04/L-50 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë e që në këtë list është edhe i pandehuri në fjalë.

Më pas gjyqtari vlersoi deklaratën e të pandehurit, pretendimin e tij se nuk ka qen i njoftuar me shkrim e as gojarisht megjithëkëtë pjesërisht i fali besimin pretendimit të tij **se nuk ka qen i njoftuar**, njeherit gjyqtari vlersoi deklaratën e Muharrem Morina pikë kontaktuesë në mes të KK Malishevës dhe Agjensioni Kundër Korrupsionit dhe e mori si bindëse dëshmin e tij ku thekson se; të njëjtin gojarisht si gjithë të tjerët i ka njoftuar në seancën e kuvendit dhe mesa di shumica e antarëve pasi që i ka njoftuar gjatë seancës së kuvendit në afatin ligjor e kan berë deklarimin e pasuris.

Pas këtij konstatimi gjyqtari i administroi provat në tërsi dhe analizoi edhe shkresat tjera të lëndës dhe duke u bazuar edhe në kërkesën e Agjensioni Kundër Korrupsionit konstatoi dhe gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elementet e kundërvajtjes nga dispozitat e shënuara më lartë andaj duke marrë për baze nenin 7 të LMK-së dhe më pas duke u thirrur edhe në nenin 9 të LMK-së i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të aktvendimit me bindje se edhe me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit, dhe se do të ndikoj pozitivisht tek I pandehuri që në të ardhmen të mos kryej kundërvajtje të tillë apo të ngajshme.

Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në bazë të nen.7 të LMK-së ,ku si rrethan rëndues vlersoi peshën dhe rrethanat në të cilat është kryer kundërvajtja, ndërsa si rrethan lehtësues mori sjelljen korrekte të pandehurit në gjykatë, ka pranuar se nuk e ka deklaruar pasurin, kushtet ekonomike të tij, prandaj duke pas për bazë këto rrethana iu shqiptua dënimi i theksuar më lartë.

Vendimi mbi shpenzimet gjyqësore, është marrë në bazë të nenit 109 par.2 të LMK-së.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË /DIVIZ KUNDËRVAJTJES/
Regj-III-nr.3228/2012, të dt.16.12.2013

Sek.juridik
Nexhmije Dakaj



Gjyqtari
Nehat Qelaj



UDHËZIME JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi kanë të drejt ankese I pandehuri dhe parashtruesi I kërkesës, Gjykatës së Apelit /Divizionit për Kundërvajtje, në Prishtinë në afatin prej 8 ditesh, pas marrjes së të njëjtit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate.